




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna Istog
Opštine Istok
Istog Municipality



DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE – ISTOG QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE-ISTOG

Në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr 03/L-212 e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nenit 4 i Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe neni 15, Statutit të Q.K.M.F në Istog shpall:

K O N K U R S I PËR S E R I T U R

Për plotësimin e vendeve të lira të Punës:

1. Titulli i vendit të punës: **Specialist i Mjekësisë Familjare**

Numri i Referencës: 1263/2020

Numri i ekzekutuesve: 1 (një)

Niveli i pagesës: 8.4

Kategoria funksionale: Niveli Profesional

Periudha e kontratës është: Në kohë të pacaktuar, (6 Muaj Periudha Provuese)

Orari i Plotë; 40 orë në javë.

Lloji i pozites: I karrierës.

Punët dhe detyra

- Ndhmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëmin të cilën është trajtuar,
- Mbanë evidencën e rregullt të dokumentacionit mjekësorë, kartelën e pacientit si dhe dokumente tjera,
- Jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtime të pacientit,
- Mbanë kujdestarinë sipas radhës,
- Është mbikëqyrës dhe përcjellë në vazhdimësi gjendjen shëndetësore të familjes,
- Ndhmon në preventimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientet në lidhje me dietë, ushqim, higjienë dhe shëndet në përgjithësi.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare- Fakulteti i Mjekësisë (specializimi nga Mjekësia Familjare)

Aftësit/ përvoja dhe atributet e tjera:

- Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
- Të jetë i licencuar;
- Përvoja e punës e dëshirueshme;
- Shkathësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;

- Shkathtësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe dhënja e këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
- Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

Dokumentet e kërkuara:

Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
Të jetë e licensuar;
Dëshmi për përvojen e punës nëse ka;
Dokumenti i Identifikimit;
Çertifikata që nuk jeni nën hetime.

2. Titulli i vendit të punës: Mjek-e i/e Mjekësisë së Përgjithshme

Numri i referencës: 1263/2020

Numri i Ekzekutuesve 1 (një)

Niveli i Pagës: Koefficienti 7.2

Kohëzgjatja e Emërimit: Më afat te pacaktuar(përudha provuese 6 muaj)

Orët e Punës: 40 Orë

Puna Provuese : 6 muaj

Punët dhe detyrat:

1. Sigurimi i shërbimeve shëndetësore në mbrojtjen parësore;
2. Kujdesi për shëndetin e pacientëve, përshkruan dhe administron tretmanët, medikamentet dhe i zbaton masat tjera shëruese;
3. Ndihmon në parandalimin e sëmundjeve dhe çrregullimeve duke këshilluar pacientët dhe popullatën në lidhje me pastërtinë dhe shëndetin në përgjithësi;
4. Jep udhëzime me shkrim dhe me gojë për trajtim të pacientit;
5. Përshkruan dhe administron medikamente;
6. Udhëzon pacientët të specialistët mjekësorë dhe shkëmben të dhënat relevante mjekësore
7. Përpilon me shkrim raportet lidhur me punën dhe veprimet e tij;
8. Ndërmerr aktivitetet për edukimin shëndetësorë të popullatës;
9. Kryen detyra të tjera ashtu si kërkon mbikqyrësi në mbarëvajtjen e punës ku është i punësuar;
10. Ndihmon dhe siguron mirësjellje e kujdes të veçantë në lëmin në të cilin është trajnuar
11. Mban kujdestarinë sipas radhës dhe kryen punë të tjera sipas kërkesës së eprorit;
12. Kryen detyra të veçanta në lidhje me profesionin e tij.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë Universitare- Fakulteti i Mjekësisë drejtimi Mjekësia e Përgjithshme.

Aftësit/ përvoja dhe atributet e tjera:

1. Minimum stazhi i Obliguar Profesional;
2. Të jetë i licencuar;
3. Përvoja e punës e dëshirueshme;
4. Shkathtësi për komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;

5. Shkathësi hulumtuese, analitike vlerësuese dhe dhënja e këshillave profesionale;
6. Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.
7. Njohja e punës me kompjuter e dëshirueshme ;

Dokumentet e kërkuara:

Diploma e Fakultetit të Mjekësisë;
Licencën e punës;
Dëshmi për përvojën e punës nëse ka;
Certifikatën e lindjes;
Certifikata që nuk jeni nën hetime.

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilët kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës,

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë nga dita e shpalljes** në mjetet e informimit.

Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionet çdo ditë pune , në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare –Istog -Zyra e Shërbimit Juridik dhe aplikacionet e plotësuara dorëzohen në të njëjtën zyre.

Me Kandidatët të cilët kanë konkuruar, do të mbahët intervista nga komisioni .

Për datën dhe kohën e mbajtjes së intervistës, kandidatët do të njoftohen me kohë.

Vërejtje: Dokumentet e pakompletura, si parashtrimi i kërkesave pas skandimit të afatit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.



DREJTORI
Dr. Ymer Vuthi

Ymer Vuthi